

DEMOKRACIA NË VEPRIM

POPULLI KA FUQI

ARJANIT (11), ERBLINA (11), MUHAMED (11), BESARTA (11), ELSA (11), FILLORETA (12), ERION (11)

ELMA (11)



Lexues të dashur, ne sot do t'iu tregojmë për demokracinë

Demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes sepse populli ka të drejtë të vendos për të ardhmen e vet. Fjala demokracia rrjedh nga gjuha greke ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë pushtet ose fuqi. Elementet kyçe të demokracisë janë: të drejtat e barabarta, liria, respektimi i ligjeve, paqja, toleranca, shprehja e mendimit, drejtësia, edukata, sinqeriteti dhe përgjegjësia. Populli ka të drejtë të vendos për përfaqësuesit e tij mbi moshën 18 vjeçare, sepse atëherë arrihet pjekuria. Demokracia ndahet në dy degë: demokracinë e drejtpërdrejtë dhe atë përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë e cila aplikohet në vendet ku është numri më i vogël i popullsisë, populli i merr vendimet aty për aty. Kurse, në demokracinë përfaqësuese populli del në zgjedhje (voton), pastaj këto vota numërohen dhe zgjedhet përfaqësuesi/ja me më

së shumti vota. Demokracia përfaqësuese ndahet po ashtu në dy sisteme: Demokracia përfaqësuese parlamentare dhe demokracia përfaqësuese presidenciale. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku populli zgjedh deputetët dhe deputetët zgjedhin Presidentin e vendit. Demokracia fillimisht u shfaq në Greqi në vitin 507 para erës sonë.

Atëherë nuk kishte demokraci të plotë sepse vetëm burrat e pasur votonin, kurse gratë dhe njerëzit e varfër nuk kishin të drejtën e votës. Kurse, tash kanë të drejtën e votës të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare pa asnjë lloj dallimi. Të gjithë duam të jetojmë në një vend ku ka demokraci sepse aty e shprehim mendimin lirshëm, aty kemi të drejta të barabarta dhe respekt. Për të arritur këtë duhet kontributi i të gjithëve në mënyrë që ta përforcojmë edhe më shumë atë. E ardhmja e vendit tonë varet nga ne, prandaj duhet të punojmë sa më shumë.



Ti je e ardhmja e vendit



Gazetarët e demokracisë

NE DHE ZGJEDHJET

FITORE (11), VALDETE (12), ANITA (12), ELONA (11), ERIONA (11), RIAD (11), EGZON (11) GENTRIT (11)

Artikulli ynë flet për zgjedhjet. Ju ftojmë ta lexoni atë dhe të informoheni më shumë


Zgjedhjet janë një proces i rëndësishëm për popullin e Kosovës sepse ne zgjedhim përfaqësuesit e vendit tonë. Këta përfaqësues janë udhëheqësit e vendit, prandaj nëse ata e udhëheqin shtetin mirë do të kemi edhe ne jetë të mirë. Ne kemi të drejtë të zgjedhim në jetën e përditshme mirëpo në procesin zgjedhor kemi të drejtë të marrim pjesë kur të mbushim moshën 18 vjeçare. Vota nuk duhet të imponohet por duhet të jetë zgjedhje e lirë e jona. Ne mund të votojmë për kryetarin e komunës e këto zgjedhje quhen zgjedhje komunale (lokale). Si dhe mund të votojmë për deputetët ku këto zgjedhje quhen zgjedhje qendrore (parlamentare). Ne mendojmë se ndryshimi vjen nga ne prandaj ne me votë vendosim të ardhmen tonë.




Autorët e artikullit




Ne zgjedhim gjatë tërë kohës. Zgjedhim lojërat që duam t'i luajmë. Zgjedhim ngjyrën e preferuar etj



Kandidatët për deputet paraqesin planprogramin e tyre para qytetarëve të vendit



Vota jote ka vlerë




Ne të gjithë kemi të drejtë të votojmë dallime feje.

Nuk ka rëndësi cilës fe i takon. Ti ke të drejtë të votosh

KUVENDI, VENDI KU MIRATOHEN LIGJET

RINESA (11), SAMIR (11), VERONA (11), RAHIME (11), DRILONA (12), ERDA (11), ADMIR (11), ENIS (11)



Jemi të lumtur për demokracinë që e kemi, sepse mënyra se si zgjedhen përfaqësuesit tonë është në mënyrë demokratike

Ne jemi nxënësit e klasës 6/3. Ne do ta marrim një shembull nga klasa jonë. Ne në klasë, kemi zgjedhur kryetaren e klasës me dëshirën tonë. Ne të gjithë kemi shkruar nga një letër me emrin e shokut apo shoqes që kemi dashur të jetë kryetare e klasës dhe në fund kemi lexuar emrat. Nxënësja që ka pasur më shumë vota është zgjedhur si kryetare e klasës. E kështu ndodhë edhe në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës është vend ku punojnë deputetët të cilët gjithsej janë 120. Në Kuvendin e Kosovës 20 vende janë të rezervuara për komunitetet joshumicë e ato komunitete janë: komuniteti serb, romë, ashkali, egjiptian, turk dhe komuniteti boshnjak. Ndërsa 100 kandidat për deputet të tjerë i votojnë qytetarët shumicë të Kosovës. Në Kuvend mbahen seancat plenare të cilat udhëhiqen nga Kryetari i Kuvendit. Në këto seanca marrin pjesë edhe Kryeministri i Kosovës, ministrat dhe zëvendësministrat të cilët e tregojnë punën e tyre dhe japin llogari para deputetëve. Gjatë këtyre seancave marrin pjesë edhe mediat të cilët interpretojnë në televizionë ngjarjet që ndodhin në Kuvend.

Kuvendi i Kosovës ka tri funksione e ato janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni i kontrollit. Funksioni përfaqësues, e ka kuptimin e asaj

që deputetët janë të zgjedhur nga qytetarët e Kosovës, dhe për këtë arsye konsiderohen përfaqësues të popullit.

Kuvendi i Kosovës e ka funksionin legjislativ ku deputetët e kanë kompetencën për të propozuar ligje dhe për t'i miratuar ato.

Ligjet miratohen me anë të votave në Kuvend dhe këto votime bëhen në tri forma: votimi me dorë, votimi me shkrim apo me letër dhe votimi elektronik. Funksioni i tretë i Kuvendit është funksioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon punën që e bënë Qeveria. Ne mendojmë se mënyra se si zgjedhen deputetët është e drejtë. Mirëpo ata që duhet të reflektojnë dhe të mendojnë mirë para se të japin votën dhe të marrin vendim. Ne qytetarët e Kosovës e jemi ata të cilët i zgjedhim përfaqësuesitë tanë.




Jemi krenarë me vendin tonë

QYTETARËT E MIRË TË KOSOVËS

AURORA (11), DAORSA (11), LORENA(11), SHKURTA(11), LABINOTI (11), SHKELQIM (12), DENIS (12),
ENDRIT (11)

Ne fëmijët e Kosovës dëshirojnë t'iu tregojnë mbi gjërat që i kemi mësuar për qytetarët aktiv

Në Punëtoritë e Demokracisë, ne kemi diskutuar për demokracinë. Demokracia është formë e qeverisjeje në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre. Ne qytetarët e Kosovës, dëshirojmë ta ruajmë Kosovën, duke mbrojtur atë nga papastërtitë. Ne duhet të respektojmë të tjerët si serbët, romët dhe ashkallitë e Kosovës. Përmes votave, ne gjithashtu kontribuojmë për shtetin tonë. Edhe pse si shtet kemi shumë ndotje, ne kemi rini të madhe dhe shpresojmë se kjo rini do të na çojë përpara. Por, nuk duhet të harrojmë të drejtat e fëmijëve, të cilat për ne janë shumë të rëndësishme. Janë po aq të rëndësishme sa pjesëmarrja në punë vullnetare dhe në organizata jo qeveritare ambientaliste. Populli i Kosovës ka të drejtat e tij.



Ta ruajmë Kosovën tonë




Qytetarët e mirë kujdesen për ambientin



Ne nuk kemi planet rezervë



Autorët e artikullit



Ndihmues i pastërtisë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë